

**RELACION
MBI
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR SHËRBIMIN PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE
ANKESAT NË
MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME”**

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjatë dy dekadave të fundit, i është nënshtruar një reformimi dhe transformimi të vazhdueshëm. Mbas viteve 2000, miratimi i ligjit nr.8749, datë 01.03.2000, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Rendit Publik”, mundësoj që shërbimi të konturohet si strukturë e cila kryen hetimin paraprak, veç veprimtarisë informative. Me miratimin e ligjit nr.10002, datë 06.10.2008, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, ai u transformua drejt një modeli me demokratik, si në aspektin e misionit, ashtu edhe në atë të detyrave funksionale, përgjegjësi, strukturës dhe personelit, duke marrë njëkohësisht edhe atributet e policisë gjyqësore. Në këtë kuadër ky shërbim, duke funksionuar si një mekanizëm për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme në radhët e Policisë së Shtetit, ka dhënë një ndikim në transformimin e qëndrimeve kundrejt përgjegjësi, si në Policinë e Shtetit, ashtu edhe në mendimin e qëndrimin e opinionit publik.

Edhe pse për këtë shërbim, janë realizuar investime të vazhdueshme, në aspektin e përmirësimit të personelit, trajtimit, trajnimit dhe pajisjeve, ai duke u krahasuar me agjencitë e mbikëqyrjes policore në vendet e tjera, nuk ka arritur të tregojë potencialin e plotë të funksionit të tij. Treguesit e punës, tregojnë për një mungesë të theksuar efëcence në aktivitetin e tij praktik dhe nuk ka ushtruar ndikimin e duhur në fushën e llogaridhënies policore, integritetit policor, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe nuk ka bërë të mundur përfshirjen e kontrollit të jashtëm qytetar ndaj saj. Efikasiteti i dobët, nuk e ka ulur nivelin e korrupsionit dhe implikimin në veprimtari kriminale, të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Ky përfundim është arritur mbi bazën jo vetëm të treguesve real të veprimtarisë së shërbimit, por dhe observacioneve të bëra nga partnerët tanë, në veçanti ICITAP.

Ligji ekzistues është vlerësuar si një ligj përgjithësisht i mirë, por për t’iu përshtatur kërkesave të kohës dhe disa parimeve mbi bazën e të cilave operojnë sot agjencitë e zbatimit të ligjit në fushën e Shërbimit për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme, në vendet e BE-së, SHBA-së apo dhe në vende të tjera, duhet t’i bëheshin disa ndryshime ose të bëhej një ligj i ri më i plotë.

Parimet mbi bazën të cilave duhet të kryeshin këto ndryshime ishin:

- policia kontrollohet nga civilët,
- realizimi i mbikëqyrjes së jashtme qytetare,
- transparenca, komunikimi dhe bashkëveprimi i drejtpërdrejtë me qytetarët,
- vendosja e ankesave në qëndër të veprimtarisë së shërbimit,
- analiza e informacionit kriminal,
- përqsja proaktive e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore,
- përgjegjshmëria dhe llogaridhënia policore,
- përafrimi me standardet e shërbimeve homologe të huaja, implementimi i parimeve të EPAC,
- pavarësia nga Policia e Shtetit etj.

Gjithashtu nga ICITAP, u sugjerua ndryshimi edhe i emërimit të shërbimit, për të patur një impakt më të madh tek publiku, si dhe për të rritur besim e publikut se ankesat e tyre do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe me paanësi. Për këtë u sugjerua që shërbimi të emërtohej "Agjencia e kontrollit civil të Policisë së Shtetit", "Agjencia për Përgjegjëshmërinë Policore" apo "Agjencia për Ankesat dhe Përgjegjëshmërinë e Policisë". Nga grupi i punës u ra dakord për vendosjen e një emërtimi të ri të shërbimit "Shërbimi për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme" i cili do të përfshinte si pjesën e traditës, "shërbimi i çështjeve të brendshme", që përcakton si frymën ashtu edhe misionin e shërbimit dhe "ankesat e publikut", për të rritur transparencën, komunikimin dhe bashkëveprimin e drejtëpërdrejtë me qytetarët.

Duke qenë se ndryshimet që sollli përfshirja e këtyre parime përbënin më shumë se gjysmën e lëndës dhe strukturës së ligjit, si nga ana sasiore ashtu edhe nga ajo cilësore, u vendos për hartimin e një projektligji të ri të Shërbimit.

Përveç përshtatshëmërisë dhe implementimit të këtyre parime në organizimin dhe funksionin e shërbimit, domosdoshmëria e hartimit të ligjit të ri rrjedh edhe nga disa faktorë të tjerë, konkretisht:

- Veprimtaria hetimore e shërbimit nuk është bazuar në elementët dhe metodat e hetimit proaktive të veprave penale, por tek ato aktive, të iniciuara me kallëzimet apo deklaratimet e kryera nga vetë qytetarët për shkeljet apo veprat penale të kryera nga punonjësit e policisë. Kjo veprimtari nuk është mbështetur tek një proces i mirëfilltë informativ, siç është grumbullimi i të dhënave nga burimet e ndryshme të informacionit, i analizimit dhe menaxhimit të këtij informacioni kriminal si dhe mbledhjes së provave nëpërmjet përdorimit të mjeteve, teknikave dhe metodave speciale të hetimit, për të dokumentuar apo parandaluar kryerjen e një veprimtarie kriminale nga punonjës policie. Në përgjithësi është operuar me rastin/ndodhinë dhe jo me çështjen/fenomenin sistematik të veprimtarisë së kundërligjshme në përgjithësi dhe të korrupsionit në veçanti të kryer nga punonjës të Policisë së Shtetit.
- Gjithashtu nuk i është kushtuar një vëmendje e veçantë trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave të qytetarëve. Kjo vihet re si në anën organizative, nëpërmjet modelit të një zyre informacioni dhe ankesave, pa një ndërvarësi të përcaktuar qartë nga strukturat e hetimit apo të inspektimit të shërbimit. Problematika ka edhe në procesin e trajtimit, shqyrtimit dhe përfundimit të ankesave të qytetarëve, duke mos krijuar kushtet e përshtatshme për ta shndërruar ankesën dhe informacionin e qytetarit, si një mjet kontrolli, transparence dhe mbikëqyrje civile ndaj vetë performacës së shërbimit.
- Në veprimtarinë inspektuese për shkak të kompetencave të cunguara e sidomos të hetimit administrativ, kanë munguar produktet antikorrupsion, e për pasojë edhe elementët e analizës së detajuar të problemit apo problematikave, të shoqëruara me konkluzionet përkatëse dhe rekomandimet e nevojshme. Por, edhe reagimi i Policisë së Shtetit, ndaj këtyre reagimeve, në mungesë të një detyrimi ligjor, ka qenë i ulët. Nuk është i përcaktuar roli proaktiv i kësaj strukture, si dhe i mungojnë instrumentet ligjore, për matjen reale të performancës policore, të përcaktuara në Kodin Evropian të Etikës Policore dhe udhëzimeve të tjera të Këshillit të Evropës në lidhje me sjelljen policore.
- Ligji ekzistues si dhe e gjithë infrastruktura ligjore paraqet mangësi, krijon hapësira dhe mundësi për interpretim në më shumë se dy kuptime, si në aspektin e veprimtarisë së shërbimit ashtu edhe në atë të menaxhimit, kryesisht të burimeve njerëzore. Kjo ka sjellë si pasojë pranime jashtë kritereve pa konkurs, pa përvojën e duhur dhe të posaçme në punë, pa

arsim përkatës të specifikuar, duke ulur cilësinë e performancës së kryer nga personeli hetues dhe inspektues i shërbimit.

- Domosdoshmëria e reformës ligjore të shërbimit, lindi edhe si nevojë e zbatimit të kërkesave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020, përshtatjes së tij me kërkesat aktuale, për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar, prioriteteve e rekomandimeve të Raport Progresit të Komisionit Evropian 2012, rekomandimeve të ICITAP dhe PAMECA - IV.

Nëpërmjet kësaj reforme ligjore synohet të zgjerohet jo vetëm objekti i veprimtarisë por edhe subjekti duke përfshirë si subjekt të mbikëqyrjes dhe kontrollit strukturat e Policisë së Shtetit, Strukturën Përgjegjëse për Ruajtjen e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, si dhe Strukturën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin. Të trija këto struktura janë struktura të zbatimit të ligjit, me status të veçantë në varësi nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe ajo çka është më thelbësore janë në shërbim të komunitetit dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me të.

Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi, forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të këtij shërbimi, organizimi i tij sipas një modeli edhe më demokratik, në zbatim të parimeve të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të individit, transparencës, kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm civil, funksionimi i plotë i përjasjes proaktive, afrimi i tij më pranë qytetarit dhe aktivizimi i kontrollit civil ndaj Policisë së Shtetit, Struktura Përgjegjëse për Ruajtjen e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin, përshtatja e shërbimit me ndryshimet bashkëkohore të shërbimeve homologe, shtimit të veprimtarive dhe të kompetencave ligjore, instrumenteve, teknikave, formave dhe metodave ligjore për krijimin e produkteve antikrim e antikorrupsion.

Risitë dhe përmirësimet e ligjit të ri, me ligjin aktual të SHKB-së.

Në ndryshim nga ligji ekzistues, ligji i ri e përafron më shumë shërbimin me statusin e nëpunësit civil, duke i dhënë një përjasje me civile veprimtarisë, funksionimit dhe organizimit të saj.

Në ndryshim nga ligji ekzistues, ligji i ri:

- Zgjeron fushën e misionit të shërbimit jo vetëm në njërin kah, në atë të garantimit të zbatimit të ligjit dhe interesave të taksapaguesve shqiptar, por edhe në kahun e mbrojtjes nga veprimtaria e mundshme kriminale dhe e kundraligjshme e kryer nga çdo punonjës i strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada.
- Zgjeron dukshëm objektin e veprimtarisë së shërbimit, duke përfshirë trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të publikut, zhvillimin e testit të integritetit, kontrollin e pasurisë së pajustificueshme të personave objekt hetimi, si dhe veprimtarinë analitiko-studimore-kërkimore-shkencore me qëllim dhënien e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësim në aspekte të organizimit dhe funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë të publikut në kuadër të rendit dhe sigurisë publike.
- Përcakton si kritere thelbësore për përzgjedhjen e drejtuesit të shërbimit karakterin etik, moral, paanësinë politike, pavarësinë nga drejtimi i strukturave që mbikëqyr dhe kontrollojnë, duke garantuar zbatimin e parimeve të pavarësisë dhe depolitizimit të Shërbimit.

- Shton disa detyrime kyçe si: kontrolli dhe raportimi, veprimi pa diskriminim, respektimi i dinjitetit dhe integritetit fizik, respektimi i shërbimit dhe ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit, deklarimi i interesave private dhe pasurisë sipas legjislacionit në fuqi, rivendosja e dinjitetit, të gjitha këto për ta vendosur shërbimin mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë.
- Përcakton më mirë fushat e veprimit të veprimtarisë informative dhe asaj hetimore. Gjithashtu është shmangur paligjshmëria e nenit 24 të ligjit ekzistues, “masat e veçanta për mbledhjen e të dhënave”, procedura që bien ndesh me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale dhe cenonjë liritë dhe drejtat e individit.
- Vendos në qendër të punës së shërbimit trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të qytetarit, duke e përcaktuar në radhë të parë si një nga objektivat e veprimtarisë së shërbimit, por edhe duke e përdorur si mjet transparence, kontrolli dhe mbikëqyrje civile ndaj shërbimit.
- Testi i integritetit që ishte përcaktuar si një formë e punës hetimore, në ligjin e ri përcaktohet si një nga objektivat e veprimtarisë së shërbimit. Ai do të kryhet mbi bazën e një udhëzuesi specifik për zhvillimin, ekzekutimin, llogaridhënien dhe dokumentimin e tij.
- Zgjeron kompetencat e inspektimit, një mjet mjaft i dobishëm në përfaqshjen proaktive të hetimit të korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit. Në ligjin e ri i përcaktohen inspektimit instrumentet ligjore që do të bëjnë të mundur jo vetëm hetimin administrativ, por edhe detyrimin ligjor për strukturat objekt i inspektimit, për të përmbushur zgjidhjen e rekomandimeve të dhëna. Kjo përcaktohet mjaft qartë në nenin 68, “Pranimi i rekomandimeve”, ku drejtuesit e strukturave pranojnë rekomandimet e shërbimit dhe i përgjigjen me shkrim, duke përshkruar veprimet që do të ndërmerren për të shënuar progres për problemet e evidentuara.
- Bën një ndarje të personelit në dy kategori, personeli operacional dhe personeli pa grada dhe me tendencë të shndërrimit të shërbimit nga një shërbim policor në një shërbim civil, gjatë një fazë implementimi 2-vjecare. Personeli operacional, do të jetë përgjegjës për ushtrimin e detyrave funksionale në fushën e veprimtarisë informative-gjurmuese, analizën e informacionit kriminal dhe aplikimit të teknikave dhe metodave speciale të hetimit. Ndërsa personeli pa grada, i cili përbën jo më pak se gjysmën e personelit të shërbimit, do të jetë personeli në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, personeli që do të kryej ushtrimin e detyrave funksionale të shqyrtimit të ankesave, të inspektimit dhe të hetimit, duke përfutur edhe të drejtën e ushtrimit të funksioneve të policisë gjyqësore, sipas Kodit të Procedurës Penale.
- Janë parashikuar dy nene, që përkatësisht, detyrojnë strukturat, të konsiderojnë rekomandimet e bëra nga shërbimi për problematikat e hasura në aspektin ligjor, organizativ, funksional, menaxhimit të burimeve njerëzore, mjeteve financiare dhe teknike, për përmirësim dhe progres, si dhe shërbimin që të bëjë transparencën me publikun dhe median, nëpërmjet publikimit të raportit vjetor të punës nëpërmjet një takimi të hapur me median të Drejtorit të Shërbimit, si dhe publikimit periodik të raporteve të inspektimit dhe çështjeve penale pas përfundimit të gjykimit në faqen e internetit të Shërbimit.

Si në ligjin ekzistues ashtu edhe në ligjin e ri është ruajtur pavarësia financiare e shërbimit, pasja dhe vetë menaxhimi i një buxheti vjetor, si dhe përcaktimi i një fondi të posaçëm në funksion të veprimtarisë informative e procedurale penale sa më efikase dhe efçente.

Ky projektligj është hartuar nga Grupi i Punës me ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të Policisë së Shtetit, të Drejtorisë së Inspeksionit të Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Drejtorisë së Sigurimit të informacionit të Klasifikuar (DSIK), të asistuar nga partnerët tanë Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin mbi Hetimet Kriminale (ICITAP) dhe PAMECA – IV.

Në hartimin e këtij projektligji jemi mbështetur në ligjin për Komisionin e Drejtësisë Penale të Kuinslëndit (kryesisht pjesa e ankesave), ligji Hungarez për Shërbimin Kombëtar të Mbrojtjes (testi i integritetit dhe kontrollin e pasurisë së pajustificueshme të personave objekt hetimi), Parimet e Mbikqyrjes Policore të miratuara në Nëntor 2011 nga partnerët Europian kundër Korrupsionit (EPAC), që janë sot parime dhe standarde udhëheqëse për të gjithë agjencitë e mbikqyrjes policore në Europë, duke i përshtatur sipas legjislacionit aktual mbi bazën e të cilit operon Shërbimi dhe legjislacionit të fushës së veprimtarisë së agjencive ligj zbatuese.

Projektligji përbëhet nga **6 (gjashtë)** pjesë dhe në mënyrë më të detajuar trajtohet si më poshtë vijon:

NË PJESËN E PARË “Dispozita të përgjithshme”, parashikohen rregullat e përgjithshme dhe parimet e misionit, organizimit dhe funksionimit të Shërbimit për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme. Ndryshe nga ligji i mëparshëm, janë shtuar disa përcaktime të domosdoshme si: fusha e zbatimit të ligjit neni 2, parimet e veprimtarisë neni 6 dhe betimi neni 7, si dhe janë përmirësuar apo ndryshuar disa përcaktime të tjera si: qëllimi, misioni, objekti i veprimtarisë, statusi i shërbimit.

Në nenin **1**, “Qëllimi” është parashikuar si qëllim i këtij ligji përcaktimi i misionit, organizimit, funksionimit, rregullimit të pozitës juridike të Shërbimit për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme, si dhe karrierës, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësit të këtij shërbimi.

Në nenin **2**, “Fusha e zbatimit të ligjit” është përcaktuar mjaft qartë se Shërbimi e ushtron veprimtarinë ndaj tre strukturave të zbatimit të ligjit, me gradë, që përdorin armë dhe që janë në kontakt të përditshëm me komunitetin, konkretisht Policia e Shtetit, Struktura Përgjegjëse për Ruajtjen e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, si dhe Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin.

Në nenin **4**, “Misioni” është përcaktuar se misioni i shërbimit është garantimi i zbatimit të ligjit dhe interesave të publikut, mbrojtja nga veprimtaria e mundshme kriminale dhe e kundraligjshme e kryer nga çdo punonjës i strukturave. Nga ky nen rrjedhin aspekte të tilla si: llogaridhënie, përgjegjshmëri ligjore dhe morale ndaj taksapaguesve shqiptarë.

Në nenin **5**, “Objekti i veprimtarisë” përveç veprimtarive të mëparshme, janë shtuar edhe: shqyrtimi i ankesave të publikut për punonjësit e strukturave, ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave, kontrolli i pasurisë së pajustificuar të personave objekt hetimi, goditja e veprimtarisë korruptive dhe kriminale, analiza, studimi dhe rekomandime të përgjithësuara mbi bazën e inspeksioneve dhe hetimeve, për probleme e problematika të organizimit, funksionit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në drejtim të sigurisë publike.

Në nenin **6**, “Parimet e veprimtarisë” janë përcaktuar shtyllat ku përqendrohen veprimtaritë e agjencive të zbatimit të ligjit, në demokracitë perëndimore, në shtetin e së drejtës, sundimin dhe zbatimin e ligjit, në respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe garantimin e interesit publikut dhe privat nëpërmjet ligjshmërisë, pavarësisë institucionale, objektivitetit,

veprimet pa diskriminim, respektimit të dinjitetit dhe integritetit fizik, proporcionalitetit, publicitetit dhe mbrojtjes së informacionit të klasifikuar.

Në nenin 7, “Simbolet dhe betimi”, është shtuar detyrimi i punonjësit, për të bërë betimin para marrjes së detyrës, si përgjegjshmëri morale dhe ligjore.

Në nenin 8, “Statusi i shërbimit” është përcaktuar se statusi i punonjësit të shërbimit rregullohet me këtë ligj dhe nuk ndryshon edhe në gjendje lufte gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.

Në nenin 9, ashtu si edhe në ligjin e mëparshëm, shërbimi ka buxhetin e vet, i cili është zë më vete në buxhetin e ministrisë dhe theksohet se fondi i posaçëm, në funksion të veprimtarisë procedurale penale dhe informative, është një zë i veçantë i buxhetit të Shërbimit, që nuk i nënshtrohet rregullave të prokurimit publik.

PJESA E DYTË “Administrimi dhe organizimi i Shërbimit”, përbëhet nga katër krerë: “Struktura”, “Autoritetet drejtuese”, “Detyrimet e personelit” dhe “Të drejtat e personelit”.

Kreu i parë “Struktura”, i cili nuk ka ekzistuar në ligjin e mëparshëm, përcakton rregullat e përgjithshme që përbëjnë strukturën e Shërbimit.

Në të ka tre nene “Administrimi i shërbimit” neni 10, i cili garanton qëndrueshmërisë në detyrë të punonjësve dhe vazhdimësinë e veprimtarisë së shërbimit, “Organizimi dhe struktura” neni 11 dhe “Strukturat qendrore dhe vendore të Shërbimit” neni 12, në të cilën është ndryshuar përmbajtja e këtij neni duke u shprehur një dallim më i qartë midis strukturave të nivelit qendror me ato të nivelit vendor, përgjegjësit e strukturave qendrore dhe ndërvarësia midis strukturave brenda juridiksionit lëndor dhe territorial.

Kreu i dytë “Autoritetet drejtuese” trajton funksionet kryesore të përgjegjshmërisë shtetërore, administrative, teknike, operacionale dhe zbatuese të veprimtarisë së Shërbimit.

Në këtë kre, krahasuar me ligjin e mëparshëm janë shtuar: “Përgjegjësitet dhe detyrat e Drejtorit të Shërbimit” neni 15, “Përgjegjësitet dhe detyrat e Zëvendësdrejtorit të Shërbimit” neni 17, “Autoriteti për të vepruar në emër të Drejtorit të Shërbimit” neni 19, si dhe “Rastet e lirimit nga detyra të Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Shërbimit” neni 20.

Ndërsa në nenet e tjera janë ndryshuar e shtuar një sërë përcaktimesh:

Në nenin 13 “Ministri” pasqyrohen kompetencat e tij si Ministri përgjegjës që mbulon fushën e veprimtarisë shtetërore të rendit dhe sigurisë publike.

Në nenin 14 “Kritere e emërimit të drejtorit të Shërbimit” janë shtuar disa kritere thelbësore si: integriteti dhe figurë të pastër morale, të mos ketë punuar në detyrën e mëparshme në kabinetet e drejtorëve të strukturave, kritere këto që shtojnë garancinë e zbatimit të parimeve të pavarësisë së Shërbimit.

Në nenin 21 “Personeli i shërbimit” një risi e këtij projektligji, është përcaktuar ndarja e personelit në personel pa grada, jo më pak se gjysma e personelit të shërbimit dhe në personel operacional. Gjithashtu mjaft e rëndësishme është fakti që i gjithë personeli i shërbimit, me përjashtim të punonjësve të shërbimeve mbështetëse, gëzojnë atributet e policisë gjyqësore sipas Kodit të Procedurës Penale.

Kreu i tretë “Detyrimet e personelit” është një Kre i cili është konceptuar pothuajse i ri. Në të janë shtuar këto nene: “Kontrolli, raportimi dhe llogaridhënia” neni 23, “Mirëadministrimi i pronës dhe kohës së punës” neni 24, “Transparenca dhe përjashtimi nga publikimi” neni 26, “Respektimi i Shërbimit dhe ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit” neni 28, “Raportimi i ankesave dhe i shkeljeve” neni 29, “Rivendosja e dinjitetit” neni 31.

Ndërkohë janë bërë përmirësime dhe ndryshime në disa nene që kanë ekzistuar të shpërndara, në ligjin e mëparshëm si: “Detyrimi i respektimit të ligjit dhe formimit profesional” neni 22, “Ruajtja e informacionit të klasifikuar” neni 25, “Kufizimi i të drejtave politike dhe të drejtës së grevës”, neni 27, dhe “Deklarimi i interesave private dhe të pasurisë” neni 30.

Në nenin 23, është parashikuar që veprimtaria e Shërbimit kontrollohet nga Kuvendi, Kryeministri, Ministri, Prokurori i Përgjithshëm, si dhe Struktura të tjera të ngarkuara me ligj dhe përcaktohet se personat e autorizuar për të kontrolluar veprimtarinë e Shërbimit, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Në nenin 25, përcaktohen detyrimet e ruajtjes dhe mos përhapjes së paautorizuar, të informacionit të klasifikuar, që ka të bëjë me të dhënat personale.

Në nenin 27, ndër kufizimet e të drejtave politike, që rrjedhin nga statusi i këtij Shërbimi, janë parashikuar edhe detyrimet e punonjësit, kur kërkon të kandidojë si deputet në Kuvend apo në organet e qeverisjes vendore, ku duhet të lirohet nga detyra pa të drejtë ripranimi.

Në nenin 30, përcaktohet që punonjësi duhet të deklarojë interesat private dhe pasurinë sipas ligjislacionit në fuqi dhe të informojë dhe marrë miratimin nga drejtori i Shërbimit për çdo veprimtari me apo pa pagesë që vendos të kryej jashtë detyrës së tij në shërbim.

Në nenin 31, “Rivendosja e dinjitetit” përcaktohet se informacionet e grumbulluara nga Shërbimi nuk përbëjnë bazë ligjore për kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe të interesave të personave fizikë e juridikë. Gjithashtu është shtuar detyrimi i Shërbimit për të rivendosur dinjitetin e punonjësit të policisë, të cenuar si pasojë e një hetimi pa bazë ligjore, nëpërmjet formave të informimit publik dhe zyrtar me shkrim.

Kreu i katërt “Të drejtat e personelit” trajton parime dhe rregulla që lidhen me këto kategori. Në këtë kre përshkruhen të drejtat kryesore të personelit si: e drejta e pagës dhe e shpërblimit, koha e punës dhe e pushimit, dhënia e pensionit dhe përfitimeve suplementare si dhe trajtimi me veshmbathje dhe uniformë, të cilat nuk kanë dallim esencial nga ligji i mëparshëm dhe janë në përputhje me statusin e nëpunësit civil, me përjashtim të përfitimeve që rrjedhin nga kushtet dhe natyra e veçantë e vendit të punës e të shërbimit, përfshirë vështirësitë e profesionit, kualifikimin dhe kohën e qëndrimit në gradë, privimet dhe humbjet për shkak të punës e të shërbimit, përdorimit të armës dhe mjeteve të forcës.

PJESA E TRETË “Kompetencat e shërbimit” përbëhet nga 5 (pesë) Krerë ku përfshihen: “Procesi informativ”, “Administrimi i ankesave të publikut”, “Veprimtaria hetimore”, “Testi i integritetit” dhe “Veprimtaria inspektuese”.

Kreu i parë parashikon rregullat e procedurat e punës me informacionin dhe të dhënat, për të gjithë veprimtarinë e Shërbimit me këtë objekt pune, duke përcaktuar norma për: mbledhjen dhe marrjen e të dhënave, kontrollin e dokumenteve dhe evidencave, kërkimin e të dhënave, marrjen e informacioneve të mbledhura në mënyrë të ligjshme, informimin e të dhënave për vepra penale, njoftimin i informatave, paralajmërimin dhe arkivin. Përveç ndryshimeve që u janë bërë në

formë e përmbajtje disa neneve që kanë ekzistuar edhe në ligjin e mëparshëm, në këtë kre është shtuar edhe një nen i ri “Paralajmërimi” neni **41**, sipas të cilit drejtori i Shërbimit ka të drejtë të paralajmërojë punonjësit e strukturave për shkelje të cilat nuk përbëjnë vepër penale, duke mundësuar parandalimin e gjenerimit në shkelje më të rënda ligjore, si dhe përfshirjes në veprimtari kriminale. Kjo do të përforcojë rolin e këshillimit si masë disiplinore ndaj punonjësve të strukturave për shkeljet gjatë ushtrimit të detyrës dhe mundësinë e përmirësimit të performancës të ushtrimit të detyrës funksionale.

Gjithashtu në këtë Kre përshkruhen rregullat e realizimit të procesit informativ, i cili është në funksion dhe në shërbim të veprimtarisë hetimore ku trajtohet: kuptimi dhe baza ligjore e veprimtarisë informative, përcjellja e informatave, trajtimi i të dhënave personale, si dhe bashkëpunimi me agjencitë e huaja homologe. Parashikohen rregulla që kjo veprimtari të kryhet vetëm në zbatim të ligjit dhe në respektim të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Gjithashtu në këtë kre trajtohen marrëdhëniet me persona dhe organizma të tjerë, ku përcaktohen detyrimet e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe private, si dhe bashkëpunimi me individë mbi bazën e legjislacionit në fuqi.

Kreu i dytë parashikon rregullat e shqyrtimit të ankesave dhe informacioneve të publikut ndaj punonjësve të strukturave, një objekt i ri i veprimtarisë së Shërbimit e pasqyruar në këtë projektligj. Si procedura më kryesore të kësaj veprimtarie janë parashikuar: “Pranimi i ankesave dhe informacioneve të publikut” neni **48**, “Vlerësimi i ankesave” neni **49** dhe “Informimi mbi zgjidhjen e ankesës” neni **50**.

Në këto nene përcaktohet se Shërbimi krijon kushte teknike e administrative për marrjen e ankesave dhe informacione nga publiku ndaj punonjësve të strukturave, që ai i percepton si shkelje të detyrës apo vepra penale, të cilat i pranon, administron, shqyrton dhe verifikon, duke ju nënshtruar procedurave të inspektimit, hetimit apo veprimtarisë informative dhe në përfundim i njofton ankimuesit mënyrën e zgjidhjes, ndërkohë që atij i krijohet mundësia teknike që të monitorojë ecurinë e vlerësimit të ankesës.

Kreu i tretë përmbledh veprimtarinë hetimore, e cila kryhet në përputhje me këtë ligj dhe në përmbushje të kërkesave që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale dhe i akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, me qëllim mos cenimin e të drejtave dhe lirive të individit dhe përmban këto nene: “Atributet e policisë gjyqësore” neni **51**, attribute këto që i gëzon i gjithë personeli i shërbimit me përjashtim të punonjësve të shërbimeve mbështetëse, “Informimi i hetimeve, ndalimeve dhe arrestimeve” neni **52**, “Mungesa e elementëve të veprës penale” neni **53** dhe “Hetimi i shkeljeve” neni **54**.

Këto nene janë konceptuar ndryshe nga ligji i mëparshëm duke u ndryshuar në formulim dhe në formë, ndërsa në nenin **51**, është shtuar e drejta e punonjësit të shërbimit me attribute të policisë gjyqësore për të vepruar edhe me iniciativën e vet, kur ka marrë dijeni për veprat penale, “Mbajtja e armës dhe mjeteve të përdorimit të forcës” neni **56** dhe “Dokumenti i identifikimit” neni **57**.

Po në këtë kre është përfshirë dhe neni **55** “Veprimtaria analitike-studimore”, me qëllim studimin dhe informimin e autoriteteve përgjegjëse, në lidhje me operimin e shërbimeve të strukturave, si dhe dhënien e rekomandimeve për të ndrequr defektet dhe ndërmarrjen e reformave ligjore apo administrative për përmirësimin e shërbimeve.

Kreu i katërt është një Kre i ri që i shtohet këtij projektligji, në të cilin përshkruhen procedurat e realizimit të testit të integritetit, ku parashikohet e drejta e kryerjes së testit të integritetit, kuptimi dhe qëllimi i tij, bashkëpunimi dhe integrimi i veprimtarisë në strukturat, si dhe vlerësimi i programit. Sipas përcaktimeve të këtij Kreu, testi i integritetit është verifikimi dhe zgjidhja e situatave duke përdorur teknika e metoda të ligjshme, me qëllim që të ruhet etika dhe integriteti i strukturave në funksion të standardeve të larta profesionale dhe etike, si dhe të krijohen produkte antikorrupsion në fushën e kontrollit ndaj korrupsionit. Testi i integritetit kryhet mbi bazen e një programi udhëzues specifik për zhvillimin, ekzekutimin, llogaridhënies dhe dokumentimin e tij.

Kreu i pestë parashikon veprimtarinë inspektuese ku përfshihen: e drejta e ushtrimit të kompetencave inspektuese, fushat e zbatimit të inspektimit, natyra e inspektimit, mënyrat e arritjes së qëllimit, si dhe procedurat e tjera të fillimit dhe realizimit të inspektimeve.

Përveç ndryshimeve të disa neneve ekzistues në këtë Kre janë shtuar: “Ushtrimi i kompetencave” neni **62**, “Fushat e zbatimit të inspektimit” neni **63**, “Natyra e inspektimeve” neni **64**, “Arritja e qëllimit të veprimtarisë së inspektimit” neni **65**, “Mirëkuptimi me strukturën që inspektohet” neni **66**, si dhe “Të drejta të tjera të inspektimit”, neni **67**, mbi bazën e të cilave punonjësit e inspektimit do të realizojnë jo vetëm hetimin administrativ, por edhe do të krijojnë produkte antikrim e anti korrupsion, si lëndë për hetimin penal.

Në kuadrin e bashkëpunimit me strukturat është shtuar detyrimi i strukturave për të pranuar rekomandimet e Shërbimit neni **68** “Pranimi i rekomandimeve” dhe për rritjen e transparencës me publikun dhe median neni **69** “Publikimi i raporteve të inspektimit dhe raportit vjetor të shërbimit” nëpërmjet një konferencë për shtyp të drejtorit të Shërbimit, duke paraqitur pikat kyçe të trajtuara në raport, konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësim jo vetëm për strukturat por edhe vetë performancën e strukturave të Shërbimit, si dhe publikimin periodik të raporteve të inspektimit dhe çështjeve penale pas përfundimit të gjyqimit, në faqen e internetit të shërbimit.

PJESA E KATËRT, përbëhet nga dy Krerë, “Gradat në Shërbim” dhe “Klasifikimi i personelit civil”.

Kreu i Parë përcakton sistemin e gradave, karrierën, emërtimet dhe hierarkinë e niveleve dhe të gradave, uljen në gradë, uljen në funksion dhe ruajtjen e gradës. Në këtë Kre e rëndësishme është të theksohet që këto grada, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e shërbimit dhe për efekt page dhe karriere, tabela e funksioneve që i përgjigjet çdo grade, paga për gradë, si dhe ekuivalentimi me gradat e Policisë së Shtetit, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, gradat në shërbim i përfiton vetëm personeli operacional dhe që përbën më pak se gjysmën e personelit të shërbimit.

Kreu i dytë përcakton nivelet e personelit civil të shërbimit, të cilët nuk përfitojnë nga sistemi i gradave në shërbim, duke iu referuar legjislacionit për nëpunësin civil.

PJESA E PESTË “Marrëdhënia e punës dhe disiplina në shërbim”, përbëhet nga dy Krerë: “Pranimi në shërbim” dhe “Disiplina në Shërbim”.

Kreu i parë “Pranimi në shërbim” parashikon “Kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbim” neni **76**, “Kriteret e arsimit sipas natyrës së punës” neni **77**, “Përvoja në punë” neni **78**.

E reja në këtë Kre është konkretizimi i kriterëve për secilën kategori të personelit, duke mos lënë shteg për interpretime me më shumë se dy kuptime. Kjo do të sjellë që në të ardhmen të

rekrutohen në shërbim punonjës edhe nga fusha të tjera, por që gjithmonë do t'i përshtaten nevojave dhe natyrës së veçante të punës së këtij Shërbimit.

Gjithashtu rekrutimi dhe futja e një personeli civil jo vetëm në veprimtarinë inspektuese por edhe në atë të trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave si dhe në hetim, do të çojë në shmangien e natyrës policore të shërbimit dhe ecjes drejt një shërbimi të mbikëqyrjes policore më civile dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun.

Janë shtuar disa nene dhe janë përmirësuar disa të tjerë si: është shtuar neni **79** “Pranimi i drejtpërdrejtë”, i cili lejon marrjen pa konkurs të personelit të nivelit zbatues me specialitet të veçantë në punë. Po kështu në nenin **80** “Kërkesa të posaçme për pranim”, është shtuar mos detyrimi i Shërbimit për të dhënë sqarime, kur aplikanti nuk plotëson kushtet për tu pajisur me certifikatën e sigurisë. Në nenin **84** “Periudha e provës” është shtuar detyrimi i specialistit që mbikëqyr punonjës në provë të nënshkruaj çdo akt të tij, si kusht për vlefshmërinë e aktit. Është shtuar neni **86** “Dorëheqja” sipas ligjit të shërbimit civil edhe punonjësi i shërbimit mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbim nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes. Në nenin **88** “Lirimi dhe përjashtimi nga shërbimi” është shtuar lirimi i punonjësit kur i shkurohet funksioni organik dhe ai nuk pranon uljen në funksion, kur ka mundësi të tilla. Është shtuar neni **89** “E drejta e punësimit në strukturat” ku i jepet mundësi punonjësit me gradë të Shërbimit, nëse ai dëshiron të largohet dhe në kuadrin e implementimit të gradave drejt statusit të nëpunësit civil, të punësohet në Policinë e Shtetit dhe strukturat subjekt të këtij ligji, në përputhshmëri me arsimin dhe kualifikimin, eksperiencën në punë dhe kërkesa të tjera ligjore.

Kreu i dytë “Disiplina në shërbim” parashikon kriteret dhe procedurat e procesit disiplinor dhe konkretisht: masat disiplinore dhe llojet e tyre, shuarja e masës disiplinore, rregullorja e disiplinës dhe hetimi i pavarur i sjelljes së punonjësit të shërbimit. Meqenëse kriteret dhe procedurat e procesit disiplinor konsiderohen si standarde, që rrjedhin nga legjislacioni i nëpunësit civil dhe rregullave të shërbimeve që me ligj mbajnë armë, nuk është bërë ndonjë ndryshim thelbësor nga ligji i mëparshëm, me përjashtim të nenit **93** “Shuarja e masës disiplinore”, ku parashikohet që masa e “përjashtimit nga shërbimi” të shuhet mbas shtatë vjetësh.

PJESA E GJASHTË “Dispozita kalimtare dhe të fundit” përcakton rregullat për dispozitat kalimtare, nxjerrjen e akteve nënligjore, afatet e shfuqizimit të ligjit të mëparshëm dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe faza e implementimit të tij duke kaluar nga shërbim me grada në një shërbim me status civil (jo më pak se gjysma e personelit të shërbimit) për një periudhe brenda 2 vjetësh.

Grupi i punës ka integruar në projektligj mjaft çështje që përmenden në Kodin Evropian të Etikës Policore dhe udhëzime të tjera të Këshillit të Evropës në lidhje me sjelljen policore, Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020, Raport Progresin e Komisionit Evropian 2012 dhe rekomandimet e ICITAP. Gjithashtu janë shfrytëzuar praktikat më të mira të legjislacionit të shërbimeve homologe evropiane, por pa ruajtur si formë dhe model asnjë prej këtyre ligjeve.

Institucionet përgjegjëse për implementimin e këtij ligji është Shërbimi për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit, Struktura Përgjegjëse për Ruajtjen e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, si dhe Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin, si dhe të gjithë ministritë apo nga institucionet që përmenden në të, që prodhojnë, administrojnë, vlerësojnë dhe verifikojnë informacion, të dhëna apo ankesa nga publiku, që kanë kompetenca të policisë gjyqësore apo

kryejnë arrestime dhe ndalime. Institucioni kompetent për kontrollin e zbatimit të këtij ligji, është Ministri i Punëve të Brendshme, si dhe ato që përmenden në këtë ligj.

Miratimi dhe implementimi i këtij ligji do të ketë efekte financiare për informatizimin e njësisë së shqyrtimit të ankesave të publikut për strukturat, arkivit dhe sektorit të analizës, kosto kjo që do të përballohet nga buxheti i Shërbimit, i miratuar për vitin 2014.

Bazuar në strukturën e miratuar për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm (e përbërë prej 104 punonjësish), në përlllogaritjet e bëra në bazë të VKM-së nr.718, datë 23.06.2009 për pagat e punonjësve të personelit të Hetimit, të Inspektimit dhe të Shërbimeve Mbështëse në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar) si dhe në zbatim të akteve të tjera ligjore e nënligjore të miratuara, që përcaktojnë financimin e detyrimeve ndaj punonjësve të Sh.K.B-së,

Fondet e akorduara për vitin 2014 janë si më poshtë:

- Artikulli “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” është në shumën 101,347 mijë lekë.
- Artikulli “Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore” është në shumën 16,472 mijë lekë.
- Artikulli “Mallra e shërbime” është në shumën 33,000 mijë lekë.
- Artikulli “Transferta për buxhetet familjare dhe individë” është në shumën 4,500 mijë lekë.

Në projektligj parashikohet shtesa prej 5 punonjësish me grada përkatësisht 3 Hetues i Parë (në nivel qendror) dhe 2 Hetues.

Efekti financiar i rritjes së numrit të punonjësve është si më poshtë:

- Për artikullin “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” është në shumën 106,315 mijë lekë.
- Për artikullin “Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore” është në shumën 17,434 mijë lekë.
- Për artikullin i “Mallra e shërbime” është në shumën 33,397 mijë lekë.
- Për artikullin “Transferta për buxhetet familjare dhe individë” është në shumën 5,292 mijë lekë.

Sa më sipër rezulton se efekti financiar (në total) që rrjedh nga parashikimi për shtimin e personelit prej 5 punonjësish është si më poshtë;

- Në shumën 4,968 mijë lekë për artikullin “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli”.
- Në shumën 962 mijë lekë për artikullin “Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore”.
- Në shumën 397 mijë lekë për artikullin “Mallra e shërbime”.
- Në shumën 792 mijë lekë për artikullin i “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”.

Efekti financiar në buxhetin e njësisë sonë shpenzuese është në shumën 7,119 lekë.

Ky projektligj iu dërgua për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Departamentit të Administratës Publike, Prokurorisë së Përgjithshme, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimit Informativ të Shtetit. Në pjesën dërmuese, mendimet e sugjerimet e dhëna u morrën parasysh dhe janë bërë pjesë e projektit, ndërsa për pjesën tjetër të pa përfshirë paraqesim argumentet si më poshtë:

1. Ministria e Drejtësisë:

- Sugjerimi që të mbahet në konsideratë parashikimi i bërë në nenin 21, të ligjit 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i cili parashikon se “*organizimi i brendshëm i ministrive dhe insitucioneve të varësisë, përfshirë dhe degët e tyre territoriale, miratohen me urdhër Kryeministri*” për nenin 11, pika 2 dhe nenin 13, pika 4, “gërma” 4, të projektligjit, nuk është refkletuar në draft. Kjo për arsye se Shërbimi për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme është një strukturë e veçantë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit e cila kryen një veprimtari komplekse, sensitive dhe konfidenciale, gjë e cila shprehet dhe në nenin 8 të projektligjit “Statusi i shërbimit”. Shërbimi ushtron kontroll dhe mbikqyrje vetëm ndaj strukturave në varësi të Ministrit të Punëve të Brendshme.
- Të gjitha sugjerimet e tjera të Ministrisë së Drejtësisë janë reflektuar në projektligj.

2. Ministria e Financave:

- Sugjerimi për shoqërimin e projektligjit me një vlerësim të detajuar të efekteve financiare që do të rrjedhin nga miratimi eventual e tij është reflektuar. Efektet financiare që do të rrjedhin nga miratimi eventual i këtij ligji, përballohen nga buxheti i miratuar vjetor i SHKB-së për vitin 2014. Për efektet financiare për vitet e tjera buxhetore, do të bëhen parashikimet përkatëse në projektbuxhetin afatmesëm referuar legjislacionit në fuqi.
- Sugjerimi që të mbahet në konsideratë parashikimi i bërë në nenin 21, të ligjit 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i cili parashikon se “*organizimi i brendshëm i ministrive dhe insitucioneve të varësisë, përfshirë dhe degët e tyre territoriale, miratohen me urdhër Kryeministri*” për nenin 11, pika 2 dhe nenin 13, pika 4, “gërma” 4, të projektligjit, nuk është refkletuar në draft. Kjo për arsye se Shërbimi për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme është një strukturë e veçantë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit e cila kryen një veprimtari komplekse, sensitive dhe konfidenciale, gjë e cila shprehet dhe në nenin 8 të projektligjit “Statusi i shërbimit”. Shërbimi ushtron kontroll dhe mbikqyrje vetëm ndaj strukturave në varësi të Ministrit të Punëve të Brendshme.
- Sugjerimi për heqjen e pikës 3, të nenit 21, nuk është reflektuar, pasi nuk bëhet fjalë për punonjësit me kontratë të përkohshme për institucionet qëndrore të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Por bëhet fjalë për punonjës që do të rekrutohen nga shërbimi, në raste të veçanta, ekspertë me njohuri të posacme në funksion të kërkesave që do të lindin gjatë veprimtarisë inspektuese apo hetimore të shërbimit.
- Sugjerimi për neni 67, pika 2, të riformulohet në kuadër të propozimit për fillimin e procesit të ecurisë disiplinore për nëpunësin civil, nuk reflektohet në draft, pasi nuk bëhet fjalë vetëm për nëpunësin civil, por për të gjithë personelin e strukturave subjekt të këtij ligji, të cilët kanë edhe personel me grada. Pra strukturat e inspektimit të shërbimit do të sugjerojnë ecurinë disiplinore, nëse pengohet kryerja e inspektimit, pavarësisht se bëhet nga personel me grada (policor) apo me status nëpunësi civil të strukturave.
- Sugjerimi për nenet 71 e 73 është reflektuar pasi, personeli i shërbimeve mbështetëse do t’i nënshtrohet legjislacionit për “nëpunësin civil”.
- Sugjerimet për nenin 76, pika 2, nuk pranohen sepse emërtimet e gradave për personelin me grada të shërbimit, janë specifikuar që janë e drejtë vetëm e shërbimit dhe ndryshojnë nga paraqitja, forma dhe emërtimi i gradave të Policisë së Shtetit.
- Projektligji sipas sugjerimit të bërë nga Ministria e Financave, është dërguar për mendim edhe pranë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, e cila është shprehur dakord.

Të gjitha sugjerimet e tjera janë refletuar në projektligj.

3. Ministria e Mbrojtjes:

- Sugjerimi për nenin 14, që Drejtori i Përgjithshëm të emërohet dhe të lirohet nga detyra nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Punëve të Brendshme, nuk është reflektuar, pasi struktura dhe organizimi i shërbimit, miratohet nga Ministri, si strukturë me status të veçantë në varësi të drejtpërdrejtë nga ministri përgjegjës.
- Në lidhje me sugjerimin për saktësimin e shprehjes “nevoja kulturore” të nenit 35, shpjegojme se “nevoja kulturore” nënkupton mbulimin e shpenzimeve në rastet e botimeve apo studimeve shkencore brenda fushës së veprimtarisë së shërbimit apo të mbikqyrjes policore. Ky sugjerim është reflektuar.
- Në lidhje me sugjerimin për nenin 100, pika 2 për riformulimin “Aktet nënligjore të nxjerra para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji”, është shtuar si dispozitë kalimtare.

Të gjitha sugjerimet e tjera janë reflektuar në projektligj.

4. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë:

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është shprehur dakord dhe pa vërejtje.

5. Departamenti i Administratës Publike (DAP)

- Sugjerimi i bërë në pikën 3, për të shtuar në nenin 85, pika 4, shprehjen “të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave”, nuk është reflektuar pasi miratimi i rregullore së personelit me vendim të Këshillit të Ministrave është parashikuar në nenin 21, pika 4 dhe nuk mund të përsëritet.

Sugjerimet e tjera janë reflektuar në draft.

6. Prokuroria e Përgjithshme:

- Sugjerimi në lidhje me nenin 3 të draftit, për të dhënë përkufizimin e disa termave të përdoruar në ligj, si: “veprimtari informative-gjurmuese”, “informacion i klasifikuar”, “rivendosje e dinjitetit”, “mjete e metoda te punës”, “procesi informativ”, “identitet i rremë”, “hetim administrativ”, “Komisioni i Mbikqyrjes së Programit”, nuk është reflektuar, pasi kuptimi i këtyre termave është i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, legjislacionin penal e procedural penal dhe Kodi i Procedurës Administrative etj.
- Sugjerimi në lidhje me nenin 6, gërma “b”, “pavarësia”, nuk është reflektuar, pasi nuk kemi të bëjme me pavarësinë kushtetuese të një organi, por flitet për pavarësinë e shërbimit nga strukturat, të cilat i mbikqyr brenda fushës së veprimit dhe në zbatim të këtij projektligji. Ky fakt reflektohet edhe në nenin 14, pika 2, gërma “f”, ku shprehem se një nga kriteret e përzgjedhjes së Drejtorit të Shërbimit është “të mos ketë punuar në detyrën e mëparshme në kabinetet e drejtorëve të strukturave”.
- Sugjerimi në lidhje me nenin 23, të projektligjit ku parashikohet “kontrolli, raportimi dhe llogaridhënia”, për të specifikuar se çfarë veprimtarie kontrollon nga Prokurori i Përgjithshëm, nuk është reflektuar, pasi veprimtaria kontrolluese e prokurorit është e përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionit përkatës në fuqi, për përdorimin e mjeteve dhe metodave speciale të hetimit.

- Sugjerimet për nenet e kreut III “Veprimtaria hetimore” dhe të disa neneve të tjera si neni 76, pika 1/a, janë reflektuar pjesërisht. Sqarohet se emërtimet e gradave për personelin operacional të shërbimit të konkretisht grada “hetues” dhe “hetues i parë”, nuk tregojnë domosdoshmërisht lidhjen me Kodin e Procedurës Penale, ku përcaktohet se kush është subjekti që kryen hetimin. Këto grada janë thjesht emërtime për efekt karriera, hirearkie brenda strukturave të shërbimit, si dhe lidhet me përvojën në punë dhe arsimin e një pjesë të personelit të shërbimit që mban grada (arsimimi dhe përvoja policore). Gjithashtu sqarohet se personeli i shërbimit që gëzon atributet e policisë gjyqësore, nuk e ka këtë atribut detyrë parësore të funksionit të tij, por e gëzon dhe e ushtron këtë të atribut në momentin që gjendet “përballë” elementëve të veprës penale që mund të jetë kryer nga punonjës të strukturave, subjekt të këtij ligji. Ndërsa sugjerimi për përcaktimin se kush do të jenë oficerët e policisë gjyqësore dhe kush agjentët, është reflektuar në draft-ligj.
- Sugjerimi i Prokurorisë së Përgjithshme për heqjen e nenit 54 “mungesa e elementëve të veprës penale”, nuk është reflektuar, pasi punonjësi i shërbimit që gëzon atributet e policisë gjyqësore bën vlerësimin nëse ka apo jo elementë të veprës penale gjatë verifikimit të një informacioni dhe nëse ka ia referon atë organit të prokurorisë dhe nëse jo, ia sugjeron strukturave përkatëse për fillimin e ecurisë disiplinore.
- Sugjerimi në lidhje me nenin 58 të projektligjit “dokumenti i identifikimit”, për riformulin në përputhje me nenet 294/a dhe 294/b të K.Pr. Penale, nuk është reflektuar në draft për arsye se në këtë nen nuk flitet për procedurën që duhet të ndjekë agjenti apo oficeri i policisë gjyqësore i Shërbimit në zbatim të neneve të sipër përmendura, “**gjatë veprimeve simuluese apo të punonjësit të policisë së infiltruar**”, por për pajisjen me dokument identifikimi të shërbimit “të rremë” në zbatim të veprimtarisë së shërbimit.
- Sugjerimet e bëra në pikën 12 të shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme janë reflektuar pjesërisht, ndërsa ruajtja e ekuivalencës për kohën e punës dhe pushimit me institucionet e tjera nuk pranohet, pasi është një e drejtë që punonjësit me grada të shërbimit, e gëzojnë aktualisht me ligjin ekzistues.

Sugjerimet e tjera janë reflektuar në draft.

Në lidhje me kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme për organizimin e një tryezë të rumbullakët me përfaqësues edhe të Prokurorisë së Përgjithshme, u zhvillua një takim pune ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Në takim u ra dakord, në lidhje me sugjerimet e paflektuara në projektligj.

7. Komisioneri për Mbrotjen e të Dhënave Personale:

Sugjerimet e dhëna nga Komisioneri janë reflektuar të gjitha në projektligj, pasi nuk ndryshonin asgjë në thelb apo në formë të projektligjit, por thjesht ishin një unifikim në terminologjinë e legjisllacionit shqiptar të përdorur në lidhje me “përpunimin e të dhënave personale”.

8. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar:

Sugjerimet e dhëna nga DSIK janë reflektuar të gjitha në projektligj, duke mos ndryshuar asgjë në thelb apo formë, por duke saktësuar disa çështje që lidhen me trajtimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, përveç sugjerimit për pikën 2, neni 23. Pranohet heqja e fjalës “të kategorisë “C”, Tepër Sekret” dhe të shtohet në vazhdim “Për nivelin e klasifikimit të informacionit që akesojnë, të lëshuar nga autoriteti kompetent”, pa përfshirë fjalët Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me argumentimin se mund të ndryshojë emërtimi i këtij institucioni apo edhe varësia e organizimi i tij.

9. Shërbimit Informativ të Shtetit:

- Sugjerimi për nenin 16, pika 2, gërma “a”, që në kriteret e emërimit në detyrë të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të njihet dhe periudha e punësimit në SHISH, nuk është reflektuar, pasi është vlerësuar si pozicion operacional i cili kërkon ekspertizë në fushat e hetimit të krimit.
- Sugjerimi për nenin 85, pika 1 nuk është marrë parasysh, sepse përcaktimi i afatit kohor nga dita e shpalljes së vendeve të lira deri në ditën e konkurimit, përcaktohen në udhëzuesin për aplikim, në faqen e internetit të shërbimit, në faqen e publikimit të shpalljeve në dy gazetat me tirazh më të madh, të cilat janë të detajuara në rregulloren e personelit, e cila do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të gjitha sugjerimet e tjera janë reflektuar në draft.

MINISTRI

SAIMIR TAHIRI